VENDIM
Nr. 103, datë 28.2.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR Nr. 67, DATË 19.12.2019, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER"

Në mbështetje të nenet 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 28.2.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 67, datë 19.12.2019, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fier"",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier (UK Fier), me shkresën nr. 116 prot., datë 26.1.2022, me lëndë "Shkresë përcjellëse", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin, sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Fier për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe më procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Fier me vendimin nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fier, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Fier sh.a., z. Petrit Kanani, ka përfunduar studimet e larta në Juridik në vitin 2013.
5. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Fier sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-ja nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Fier është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Fier" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Petrit Kanani.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani